

STATISTIKAT E TRANSPORTIT

RRUGOR

Tremujori II, 2026

Në tremujorin e dytë 2026, numri i mjeteve rrugore në qarkullim në territorin e Shqipërisë ishte 1.092.726. Ndër to, autoveturat përbëjnë 80,7 % të mjeteve gjithsej, të ndjekura nga motorët me 6,3 % dhe automjetet për transport të përzier me 5,8 %.

Tirana zë peshën më të madhe me 34,8 % të mjeteve gjithsej, ndjekur nga Durrësi me 13,7 %. Ndërkohë, Gjirokastra dhe Kukësi kanë numrin më të ulët të mjeteve, përkatësisht me 2,1 % dhe 2,4 %.


Gjatë këtij tremujori janë regjistruar për herë të parë 26.738 mjete, nga të cilat 78,7 % ishin autovetura. Sërish, qarku i Tiranës udhëheq me 44,5 % të regjistrimeve të reja.

Ndryshimet, krahasuar me të njëjtin tremujor të vitit 2025:

- Numri total i mjeteve është rritur me 9,0 %.
- Regjistrimet e reja kanë shënuar një rënie prej 0,9 %.

Në mjetet e regjistruara për herë të parë, Volkswagen mban vendin e parë me 16,4 %, e ndjekur nga Mercedes Benz me 14,0 %.

FIG. 1 MJETE RRUGORE TË RREGJISTRUARA PËR HERË TË PARË SIPAS MARKËS, TREMUJORI II-2026



Shënim për përdoruesit: Të dhënat e detajuara mujore dhe vjetore sipas grupeve janë të disponueshme në databazën statistikore të INSTAT: [Statistikat e Transportit Rrugor](#), si dhe në seksionin e tabelave në website në temën: [Statistikat e Transportit Rrugor](#)

Metodologjia

Publikimi i Statistikave të Transportit Rrugor paraqet rezultatet mbi Inventarin e mjeteve rrugore me frekuencë tremujore. Të dhënat janë administrative dhe burimi kryesor i informacionit është Drejtoria e Përgjithshme e Shërbimeve të Transportit Rrugor.

Përkufizime

Transport: Lëvizja e njerëzve dhe/ose mallrave, duke përdorur mjete të ndryshme transporti. Transporti mund të kryhet me mjete të transportit hekurudhor, tokësor, detar dhe ajror.

Transporti rrugor: Çdo lëvizje e mallrave duke përdorur një mjet rrugor në një rrjet të caktuar rrugor.

Autoveturë - Mjet motorik i transportit rrugor i destinuar për transport pasagjerësh, në të cilin numri i vendeve të uljes (duke përfshirë edhe shoferin) nuk e kalon numrin 9.

Autobus - Mjet motorik i transportit rrugor i destinuar për transport pasagjerësh me numrin e vendeve të uljes (duke përfshirë dhe vendin e shoferit) me më shumë se 9 vende.

Kamion - Mjet i destinuar për transportin e mallrave dhe të njerëzve të caktuar me përpunimin ose transportin e këtyre mallrave.

Motor - Mjet motorik i transportit rrugor me dy, tre ose katër rrota që nuk i kalon 400 kg peshë pa ngarkesë.

Rimorkio për transport mallrash - Mjet rrugor për transportin e mallrave i projektuar për t'u tërhequr nga një mjet motorik i transportit rrugor.

Automjete për transport të përzier (ATP) - Përfshihen mjetet që kanë një peshë të përgjithshme me ngarkesë të plotë jo më të madhe se 3.5 tonë, ose 4.5 tonë kur ka tërheqje elektrike me bateri; janë të destinuara për transport njerëzish dhe mallrash me kapacitet maksimal nëntë ndenjës, duke përfshirë dhe ndenjësën e drejtuesit të mjetit.

Automjete për transport të veçantë (ATV) - Mjet transporti i destinuar për transportin e disa mallrave ose njerëzve të caktuar në kushte të veçanta dhe karakterizohet nga pajisja në mënyrë të përbashkët, me mekanizma special që i shërbejnë këtij qëllimi.

Automjete për përdorim të veçantë (APV) - Mjete të pajisura në mënyrë të përhershme me mekanizma të vecantë dhe të destinuar përgjithësisht për transportin e këtyre mekanizmave; mbi këto automjete lejohet transporti i personelit dhe i materialeve që kanë lidhje me ciklin operativ të këtyre mekanizmave, si dhe transporti i njerëzve dhe mallrave që kanë lidhje me destinacionin e përdorimit të këtyre mekanizmave.

Të dhënat e transportit rrugor janë paraprake dhe subjekt rishikimi. Për më shumë, referohu: Politika e Revizionimit Statistikor.

Shpjegimi i simboleve

0 vlerë më e vogël se gjysma e njësisë matëse

- pa vlerë

(...) mungesë të dhënash